

Mbështetje për "Lobin..." nga të dy qeveritë

Në një kumtesë për shtyp "Lobi Shqiptar në Evropë" që vepron në Gjermani njofton se në prag të festave të fundvitit që shkoi një përfaqësi e tij është pritur nga zyra e kryeministrit të Shqipërisë Sali Berisha dhe nga kryeministri i Kosovës Agim Çeku. Të dy kryeministritë mbështesin Lobin Shqiptar në Evropë. Përfaqësues të këtij Lobi kanë paraqitur objektivat e tyre për vitin në vijim pranë dy qeverive tona asaj të Shqipërisë dhe Kosovës

Një përfaqësi e "Lobit Shqiptar në Evropë" e kryesuar nga kryetari z.Nikollë Shabani dhe e përbërë nga anëtarët zotërinjtë Rasim Sadiku, Ejup Murseli, Sheremet Pantina dhe shtetasi Holandez ,me përfaqësi në Gjermani ,ekspert për sigurinë e kompanive dhe koncerneve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Evropën Lindore z.Richard Aschmann janë takuar me Kryeministrin e Kosovës Agim Çeku dhe këshilltarë të kryeministrit Berisha në prag të festave të fundvitit. Në fjalën e tij zoti Shabani thekson se takimet kanë pasur si qëllim prezantimin e objektiveve të Lobit për vitin në

vijim, objektiva të cilat do të finalizohen vetëm duke pasur mbështetjen e qeverive të dy vendeve tona. Qëllimi ynë kryesor ka qenë institucionalizimi i veprimtarisë sonë të mëtejshme në funksion të dhënies së kontributeve konkrete në disiplinën e ndryshme të jetës sikurse janë ato politike ekonomike sociale dhe deri tek më e rëndësishmja çështjet në interes të kombit tonë sikurse është Pavarësia e Kosovës dhe futja sa më parë e të dy vendeve në Bashkimin Evropian. Lidhur me dy pikat e fundit thekson z. Shabani duke filluar nga muaji janar fillojmë takimet me personalitete të

larta të jetës Politike në Evropë takime të cilat do ti paraqesim here pas here në organe te ndryshme te shtypit shqiptar.

Takimet zyrtare të zhvilluara në Shqipëri dhe Kosovë kanë qenë tepër të suksesshme, për vetë faktin se nga të dy kryeministrat u tregua gatishmëri për bashkëpunim, mbështetje dhe përkrahje gjithëpërfshirëse. Dhe kjo gjë na bën të ndihemi optimist për të ardhmen e Lobit funksioni, dhe objektivat e të cilit kanë qenë dhe do të jenë në dobi të kombit tonë.

Ndërsa më konkretisht me këshilltaren për ekonomi pranë kryemi-

nistrit Berisha është folur rabi projektet ekonomike që ka Lobi Shqiptar projekte të cilat mbështeten në interesimin serioz të firmave të mëdha evropiane për investime në Shqipëri dhe Kosovë. Gjithashtu potencial mjaft i rëndësishëm mbeten edhe biznesmenët shqiptar që jetojnë në Evropë dhe për këtë kategori të interesuarish janë premtuar favorizime të ndryshme nga ana e qeverisë.

Një tjetër synim mjaft i rëndësishëm i këtij organizimi është ingranimi brenda Lobit i politikanëve evropianë të cilët janë në fuqione te ndryshme qeverisëse,kjo

do të bëj të mundur përfundon fjalën e tij zoti Shabani gërshetimin e veprimeve tona me politikanët Evropian me ata Shqiptar në funksion të zgjidhjes së probleme të shqiptarëve që jetojnë në Evropë dhe atyre që jetojnë në troje të ndryshme shqiptare si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mali i Zi.

Vlen të theksohet fakti që takimet në të dyja kryeministritë u pasqyruan nga Televizioni publik shqiptar dhe RTK, me ç' rast në emër të Lobit Shqiptar në Evropë Zoti Shabani ju uroi festat e fundvitit të gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen", thuhet në përfundim të kumtesës. ■

Tuqishëm prezantuan vullnetin e